



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government**


Për:	<b>Shpejtim Bulliqi</b> , Kryetar i Komunës së Podujevës <b>Fatmir Gashi</b> , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<b>Elbert Krasniqi</b> , Ministër i MAPL-së <b>Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL</b>	
Nga:	<b>Venera Çerkini</b> , Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 020-337 13.04.2021
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor <b>Xhevat Tafa</b> , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor <b>Edmond Kuka</b> , Zyrtar për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:






<b>Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në fshatin Batllavë</b>
I miratuar më datë: 08.04.2021
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 12.04.2021

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Za:	Shpejtim Bulliqi, gradonačelnik Opštine Podujevo Fatmir Gashi, predsedavajući Skupštine opštine Podujevo	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a,  Trim Berisha, zamenik generalnog sekretara MALS-a, 	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS 	Dana, 13.04.2021. Br. 020-337
Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština 	
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Edmond Kuka, službenik za monitorisanje opština 	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Podujevo	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Podujevo,	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akata opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

**Odluka o uspostavljanju komisije za procenjivanje za sprovođenje postupaka za davanje na korišćenje nepokretne imovine opštine u selu Batlava**


Usvojena dana, 8.4.2021.

Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 12.04.2021.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta

procenjuje da je opštinski akt iz proceduralnog aspekta u saglasnosti sa **zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi**.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d) dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 17 të Rregullores QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të nenit 15 paragraf. 2.4, dhe nenin 17 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 08 prill 2021, miratoi këtë:

### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Batllavë

##### Neni 1

Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës sipas vendimit nr.prot. 01-463/02-0031662/21 datë 08 prill 2021 për miratim paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, pronën e paluajtshme të Komunës në fshatin Batllavë, në këtë përbërje:

1. Bahri Selimi, nga Ekzekutivi i Komunës
2. Pajtim Balaj, nga Ekzekutivi i Komunës
3. Agron Hyseni, nga Kuvendi i Komunës
4. Bahri Blakçori, nga Kuvendi i Komunës
5. Shemsi Jashari, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni i cili organizon dhe kryeson punën e komisionit.

##### Neni 2

Mandati i komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit nr.prot.01-463/02-0031662/21 të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës të datës 08 prill 2021.

##### Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

##### Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës

##### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

##### Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-463/02-0031683/21  
Podujevë, 08 prill 2021



Kryesuesi i Kuvendit  
Fatmir Gashi